



Prof. Dr. Vasilika Kume

Rektore

Tirana Business University College

Vasilika Kume është angazhuar në mësimdhënie në Fakultetin e Ekonomisë që nga viti 1986. Gjatë periudhës 1986-1991 ka kryer studime pas universitare në fushën e Menaxhimit. Në 1998 mori titullin “Profesor i Asociuar” dhe në 2001 mori titullin “Profesor”. Gjatë periudhës 1998-2012 ka qenë Drejtore Ekzekutive e Programit Master, në Fakultetin Ekonomik.

Vasilika Kume është anëtare e disa bordeve, që përfshijnë borde botuese dhe shkencore në revista ndërkombëtare. Ajo është autore e mbi 40 artikujve shkencorë dhe ka marrë pjesë në shumë konferenca brenda dhe jashtë vendit. Ajo është autore e disa teksteve shkencore brenda dhe jashtë vendit.

Vasilika është angazhuar si pedagoge me kohë të pjesshme në disa universitete jashtë vendit, si Kosovë, Maqedoni dhe si profesor i ftuar në Universitetin Worms. Për disa vite ajo është angazhuar në kursin e "Menaxhimit Strategjik", për studentët e IMBA, në Universitetin Worms, Gjermani.

Vasilika Kume është ftuar si trajnuese nga disa institucione dhe kompani private në Zgjidhjen e Problemeve, Liderhipin, Menaxhimin e Ndryshimeve, Strategjinë e Biznesit dhe ka qenë e angazhuar në disa projekte brenda dhe jashtë vendit

Ajo ka drejtuar disa studentë të doktoraturës në vend dhe jashtë saj (Maqedoni, Kosovë).

Fusha e kërkimit: Menaxhimi strategjik, planifikimi strategjik në organizatat publike dhe jofitimprurëse, menaxhimi i kohës, plani i biznesit, marrja e vendimeve menaxheriale, menaxhimi i mbeturinave urbane.

Lëndët: Menaxhim Strategjik, Marrje Vendimesh Menaxheriale, Menaxhim Strategjik i Avancuar, për nivelin e parë dhe të dytë të studimeve.